



Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 , nenit 8 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nr.04/L-144 dhe nenit 2 të Rregullores QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e III-të të rregullt të punës, të mbajtur më datën 30.03.2018, mori këtë:

## V E N D I M

### I

**THEMELOHET** Komisioni për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës në afat shkurtër dhe afatgjatë.

### II

Komisioni përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, tre (3) anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës, të propozuar nga Kryetari i Komunës, tre (3) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjekte të ndryshme të përfaqësuara në Kuvend dhe një (1) anëtar ekspert nga shoqëria civile.

Përbërja e komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi caktohet, siç vijon:

1. Petrit Palushaj-KK
2. Zeqir Morina-KK
3. Enver Gashi-KK
4. Lorenc Marleku-Ekzekutivi
5. Naser Morina - "
6. Iber Elezaj - "
7. Florida Gashi-OJQ

### III

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave zgjedhin Kryesuesin e Komisionit.

### IV

Përgjegjësit e këtij Komisioni rregullohen me dispozitat e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës nr.04/L-144 dhe Rregulloren QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

### V

Mandati i anëtarëve të Komisionit përcaktohet më vendim të Kuvendit të Komunës dhe nuk mund të zgjat më shumë se mandati i rregullt ligjor i anëtarëve të Kuvendit.  
Ky vendim shfuqizon vendimin 01Nr.06-1514 të datës 10.03.2014.

### VI

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Klinës ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në Autoritetin Mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

01Nr. 060-2627 2018  
Më datë 05.04 2018

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

Kryesuesi i Kuvendit,  
Fadil Gashi

